

Kosova ndan rreth
255 000 euro për tekstet
shkollore për Luginën
e Preshevës | FAQE 6



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

MBAHET MBLEDHJA E RADHËS E QEVERISË SË KOSOVËS | FAQE 3

KURTI: DREJTËSIA JONË VAZHDON TË JETË JOEFIKASE DHE E NGADALTË, VETINGU ËSHTË ZGJIDHJA



Në mbledhjen e 154-t të
qeverisë, kryeministri Albin
Kurti ka folur për sistemin e
drejtësisë në vend, duke
theksuar se janë të shumta rastet
kur, si pasojë e mosveprimit të
sistemit të drejtësisë, persona të

ndryshëm me precedentë të
shumtë penalë lëvizin lirshëm,
qoftë të liruar nga organet apo
edhe të pandjekur fare penalisht,
e të cilët rrezikojnë dhe marrin
jetën e qytetarëve tanë. Ai ka
theksuar se reforma është

domosdoshmëri e vetingu është
zgjidhja. "Raporte të ndryshme
kredibile vendore dhe
ndërkombëtare konstatojnë se
drejtësia jonë vazhdon të jetë
joefikase dhe e ngadaltë", është
shprehur Kurti

SHTETET E
BALLKANIT
"DUHET TË
MARRIN
VENDIME TË
VËSHITRA
SHPEJT" | FAQE 7



RIKTHEHET GJYKIMI NDAJ
THAÇIT DHE TË TJERËVE | FAQE 3



LDK-JA KËRKON HETIM
PARLAMENTAR PËR REZERVAT
SHTETËRORE | F. 8

MINISTRI PECI: DO TË
EKZEKUTOHEN RRETH
30 MILIONË EURO PAGESA PËR
SUBVENCIONE DHE GRANTE | F. 8



SYLVINHO: ËNDËRROJMË
KUALIFIKIMIN NË 'EURO 2024' | F. 10

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Mbi 40 migrantë vdesin pas fundosjes së anijes në Mesdhe

SICILI, 9 GUSHT - Dyzet e një persona besohet se kanë vdekur pasi një anije me migrantë u fundos afër brigjeve të Tunizisë në Detin Mesdhe, raportoi televizioni shtetëror italian, RAI, duke u bazuar në dëshmitë e katër personave që mbijetuan. Sipas agjencisë së lajmeve ANSA dhe televizionit RIA, katër personat fillimisht u shpëtuan nga një anije malteze në Ngushticën e Sicilisë. Të mbijetuarit më pas u transferuan te rojet bregdetare italiane, të cilët i sollën në ishullin sicilian të Lampedusës. Ky ishull, që është më afër Afrikës sesa tokës italiane, është destinacion i shpeshtë për trafikantët e migrantëve dhe shihet si qendër ku mbahen migrantët. Ishulli është mbipopulluar me ardhjen e migrantëve të rinj gjatë kësaj vere.

Alessandra Filograno, zëdhënëse e Kryqit të Kuq italian, konfirmoi se katër të mbijetuarit kanë arritur në qendrën në Lampedusa mëngjesin e së mërkurës. Ajo tha se bëhet fjalë për dy burra, një grua dhe një minorene të pashoqëruar. Ajo nuk dha më shumë detaje.

ANSA dhe RAI raportuan se, sipas dëshmive të katër të mbijetuarve, ata kishin udhëtuar nga Bregu i Fildishtë dhe Guinea. Këto dy media italiane thanë se në mesin e viktimave janë edhe tre fëmijë.

Këtë verë janë fundosur një numër i anijeve me migrantë, që janë nisur nga Tunizia drejt Italisë. Sipas Ministrisë së Brendshme të Italisë, mbi 93 000 migrantë kanë arritur në Itali deri më tani gjatë këtij viti, që është dyfish më shumë sesa 45 000 persona që kishin arritur në këtë shtet në periudhën e njëjtë të vitit



2022.

Shumica e migrantëve janë nga Guinea, Bregu i Fildishtë, Egjipti dhe Tunizia.

Kryeministrja e Italisë, Giorgia

Meloni, në qeverinë e djathtë të së cilës përfshihet edhe partia anti-migrante, Liga, i ka bërë thirrje Bashkimit Evropian të bashkohet në përpjekjet që të

nxitet Tunizia për t'i goditur operacionet e trafikimit të migrantëve, por anijet me migrantë po vazhdojnë të arrijnë në brigjet italiane.

Shtetet e Amazonës kërkojnë veprime urgjente për ndryshimet klimatike

BRAZILIA, 9 GUSHT - Tetë shtete të Amazonës u kanë bërë thirrje shteteve të industrializuara që të bëjnë më shumë për të ndihmuar në ruajtjen e pyllit më të madh tropikal të botës gjatë takimit në një samit në Brazil, ku diskutuan për një qasje të përbashkët se si të luftohen ndryshimet klimatike, raporton AP.

Samiti dyditor i udhëheqësve të shteteve të Amerikës së Jugut, ku gjendet edhe Amazona, përfundon të mërkurën. Liderët thanë se detyra e ndaljes së shkatërrimit të pyllit nuk mund të bjerë vetëm mbi disa shtete, kur kriza është shkaktuar nga shumë shtete.

Anëtarët e Organizatës së Traktatit për Bashkëpunim në Amazonë, apo ACTO, po shpresojnë se një front i bashkuar do t'u japë zë më të fuqishëm në bisedimet globale. "Pylli na bashkon. Është koha që ta shohim zemrën e kontinentit tonë dhe ta konsolidojmë një



herë e mirë identitetin tonë të Amazonës", tha presidenti i Brazilit, Luiz Inacio Lula da Silva. Thirrjet e presidentëve të shteteve, përfshirë të Brazilit, Kolumbisë dhe Bolivisë, u bënë

në kohën kur liderët po tentojnë ta nxisin zhvillimin ekonomik në rajonet e tyre dhe të njëjtën kohë të parandalojnë që situata në Amazonë "të mos arrijë në pikën ku më nuk do të ketë kthim

prapa", u tha në deklaratën e përbashkët të lëshuar pas ditës së parë të samitit.

Disa shkencëtarë kanë thënë se kur 20 deri në 25 për qind e pyllit të shkatërrohet, reshjet do të

reduktohen në mënyrë dramatike, duke e transformuar më shumë se gjysmën e pyllit në një savanë tropikale dhe duke shkaktuar humbje të madhe të biodiversitetit.

Samiti përforcon strategjinë e Lulas që ta rrisë shqetësimin në nivel global për ruajtjen e Amazonës. I inkurajuar nga një rënie prej 42-përqindësh e shpyllëzimit gjatë shtatë muajve të parë që kur ka marrë pozitën e presidentit, ai synon të kërkojë mbështetje ndërkombëtare financiare për mbrojtjen e pyllit. Amazona shtrihet në një sipërfaqe dy herë më të madhe sesa madhësia e Indisë. Dy e treta e Amazonës gjendet në Brazil, ndërsa pjesa tjetër në shtatë shtete të tjera dhe një territor. Qeveritë historikisht e kanë parë këtë hapësirë si zonë që mund të kolonizohet dhe shfrytëzohet, me pak përfillje për qëndrueshmërinë ose të drejtat e popujve indigjenë që jetojnë aty.

Trafiku Shkodër - Tiranë, Rama: E ka rënduar turizmi, vazhdon puna me ritme të shpejta për segmentet problematike

SHKODËR, 9 GUSHT - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka kërkuar ndjesë dhe durim qytetarëve dhe turistëve, të cilët çdo ditë ndeshen me trafik të rënduar në aksin Shkodër - Tiranë këtë verë. Rama thotë se rritja fluksit të

vizitorëve në këtë sezon për industrinë e turizmit e ka rënduar edhe më shumë se zakonisht situatën e trafikut përgjatë këtij aksi, sidomos në segmentin Milot - Kashar.

Kryeministri Rama ka theksuar se ky problem do të vazhdojë për disa kohë në

mungesë të Korridorit Blu, por vazhdon puna e projekteve dhe financimeve, për ta lidhur Shqipërinë perëndimore nga veriu në jug me Korridorin Blu, një autostradë e mirëfilltë e standardeve evropiane, e cila ka hyrë më në fund në një fazë konkretizimesh.



MBAHET MBLEDHJA E RADHËS E QEVERISË SË KOSOVËS

Kurti: Drejtësia jonë vazhdon të jetë joefikase dhe e ngadaltë, vetingu është zgjidhja

Në mbledhjen e 154-t të qeverisë, kryeministri Albin Kurti ka folur për sistemin e drejtësisë në vend, duke theksuar se janë të shumta rastet kur, si pasojë e mosveprimit të sistemit të drejtësisë, persona të ndryshëm me precedentë të shumtë penalë lëvizin lirshëm, qoftë të liruar nga organet apo edhe të pandjekur fare penalisht, e të cilët rrezikojnë dhe marrin jetën e qytetarëve tanë. Ai ka theksuar se reforma është domosdoshmëri e vetingu është zgjidhja. “Raporte të ndryshme kredibile vendore dhe ndërkombëtare konstatojnë se drejtësia jonë vazhdon të jetë joefikase dhe e ngadaltë”, është shprehur Kurti

EPOKA E RE

Mal QORRAJ

Prishtinë, 9 gusht - Në mbledhjen e 154-t të qeverisë, kryeministri Albin Kurti ka folur për sistemin e drejtësisë në vend, duke theksuar se janë të shumta rastet kur, si pasojë e mosveprimit të sistemit të drejtësisë, persona të ndryshëm me precedentë të shumtë penalë lëvizin lirshëm, qoftë të liruar nga organet apo edhe të pandjekur fare penalisht, e të cilët rrezikojnë dhe marrin jetën e qytetarëve tanë.

Ai ka thënë se edhe raporte të ndryshme kredibile vendore dhe ndërkombëtare konstatojnë se drejtësia jonë vazhdon të jetë joefikase dhe e ngadaltë dhe të përshkruhet me fenomenin e rasteve të shumta në rigjykim dhe vendimeve jo të duhura ndëshkimore. “Nuk mungojnë edhe rastet më ekstreme, madje tashmë të njohura edhe për publikun, kur nga dënimi me burgim të përjetshëm të shqiptuar në shkallë të parë, instanca e fundit, Gjykata Supreme, kishte liruar tërësisht nga akuzat të pandehur, në një proces maratonik gjyqësor, të gjykuar dhe rigjykuar. Në shumë raste, kur ndodh një krim, duhet të ngritet shoqëria në mënyrë që të kemi vendim meritore nga gjykata. Shembull është rasti i fundit me shqiptimin e dënimit me burgim të përjetshëm të vrasësit të së ndjerës Marigona Osmani, pra Dardan Krivaqa. U dashtë një shoqëri e një popull i

tërë ta dënojë publikisht krimin në mënyrë që gjykata të mund ta nxjerrë një verdikt meritore”, është shprehur Kurti.

Ai ka theksuar se vendimet meritore të sistemit të drejtësisë kanë ndikim të dyfishtë në shoqërinë e çdo vendi. “Përveçse sjellin drejtësi për viktimat dhe të dëmtuarit, ato diktojnë edhe parashikueshmërinë e pasojave të çdo veprimi jo të ligjshëm e penal, duke ndikuar kështu edhe në parandalimin e krimeve. Niveli i besimit të qytetarëve në organet e drejtësisë vazhdon të jetë ndër më të ulët në krahasim me institucionet e tjera. Sipas Raportit të UNDP-së dhe USAID-it - Puls Publik, i publikuar këtë vit, tekso niveli i kënaqshmërisë për qeverinë është rritur mbi 50 për qind, për



organet gjyqësore dhe ato vazhdon të jetë i ulët. Sipas po prokuroriale trendi i tillë këtij raporti, kënaqshmëria e

qytetarëve për performancën e sistemit të drejtësisë - gjykata dhe prokurorinë - është vetëm 29 për qind”, ka thënë ai.

Kryeministri ka shtuar se sipas statistikave të gjyqësorit, gjatë vitit 2022 Gjykata e Apelit kishte kthyer në rigjykim 1 754 raste. “Ky raport e rëndon sistemin e drejtësisë, e ngulfat atë, e vonon drejtësinë, e humb besimin e qytetarëve dhe, si efekt përfundimtar, në mungesë të ndëshkueshmërisë efikase, rrezikon ta inkurajojë krimin dhe kriminalitetin. Andaj, reforma është domosdoshmëri e vetingu është zgjidhja. Tash e pesë muaj jemi në pritje që Gjykata Kushtetuese t’i hapë sa më shpejt rrugë jetësimi të kësaj reforme. E koha po kalon. Koha që kalon është kohë e humbur”, ka deklaruar Kurti.

“Letra e ligjvënësve na përforcon përkushtimin për shtensionim në veri”

Kryeministri Albin Kurti në mbledhjen e qeverisë i ka njoftuar ministrat se këtë javë pati edhe një zhvillim pozitiv për Republikën e Kosovës në rrafshin ndërkombëtar. “Përmes një letre drejtuar sekretarit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Antony Blinken, përfaqësuesit të Lartë të BE-së për Politikë të Jashtme dhe Siguri, Josep Borrell, dhe ministrit të Punëve të Jashtme të Mbretërisë së Bashkuar,

James Cleverly, mbi 50 deputetë, në mesin e tyre edhe senatorë e kongresistë amerikanë, 10 kryetarë të komisioneve parlamentare të politikave të jashtme të 16 shteteve, përfshirë edhe Ukrainën, kanë shprehur mbështetjen e tyre për Kosovën dhe kanë bërë thirrje për qasje më të ashpër ndaj Serbisë dhe rrezikut që veprimet e saj paraqesin për sigurinë e rajonit tonë”, ka njoftuar Kurti. Ai ka

thënë se Kosova është falënderuese për të gjithë përfaqësuesit politikë që i janë bashkuar kësaj thirrjeje të përbashkët. “Mirëpresim secilin nënshkrim dhe mbështetje të radhës. Ky lloj i mbështetjes na e forcon përkushtimin tonë për deeskalim të plotë të situatës në katër komunat në veri të Kosovës, angazhimin për demokraci, dhe bindjen për ligjshmëri e kushtetutshmëri”, ka deklaruar Kurti.

Rikthehet gjykimi ndaj Thaçit dhe të tjerëve

HAGË, 9 GUSHT - Pas pushimeve të verës, javën e ardhshme do të rifillojë gjykimi në rastin e Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit e Rexhep Selimit. Në Hagë pritet të vazhdojnë dëshmitë e dëshmitarëve të radhës. Gjykimi ndaj Thaçit dhe të tjerëve, sipas kalendarit, parashihet të mbahet nga data 14, 15, 16 dhe 17

gusht, duke vazhduar më tutje nga 28, 29 dhe 30 gushti. Gjykimi ndaj katërshes së UÇK-së nisi më 3 prill 2023, pas më shumë se dy vjetësh zvarritje. Thaçi, Veseli, Krasniqi dhe Selimi po qëndrojnë në paraburgim në Hagë që prej nëntorit të vitit 2020. Ata akuzohen nga Zyra e Prokurorit të Specializuar me akuzat për

krime kundër njerëzimit, si përndjekje, burgosje, akte çnjerëzore, torturë, zhdukje dhe vrasje, si dhe me 4 pika për krime lufte si arrestim, ndalim arbitrar, torturë dhe vrasje të paligjshme. Ata janë deklaruar se janë të pafajshëm për akuzat e ngritura ndaj tyre. Deri më tani ndaj Thaçit dhe të tjerëve kanë dëshmuar 15 dëshmitarë.





Shtetet e Ballkanit 'duhet të marrin vendime të vështira shpejt'

Deputeti holandez i Parlamentit Evropian, Thijs Reuten, ka folur për thirrjen e fundit të deputetëve amerikanë dhe evropianë ndaj kryediplomatëve të Shteteve të Bashkuara, Britanisë së Madhe dhe Bashkimit Evropian, për ta ndryshuar qasjen ndaj Kosovës dhe Serbisë. Reuten, i cili është një prej nënshkruesve të dokumentit, bashkë me të tjerët po kërkojnë dy gjëra: rikthim të negociatave për normalizim, dhe stabilizim në rajon përmes një qasjeje të qartë e të koordinuar dhe jo ashtu siç e kemi parë në muajt e fundit

Prishtinë, 9 gusht - Deputeti holandez i Parlamentit Evropian, Thijs Reuten, beson se diplomacia parandaluese garanton stabilitet në rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe ofron mundësi për reagim ndaj secilës krizë eventuale. Në një intervistë për "Radion Evropa e Lirë", Reuten, i cili është edhe anëtar i Komitetit për Punë të Jashtme në Parlamentin Evropian, e ka komentuar thirrjen e dhjetëra deputetëve amerikanë, britanikë dhe atyre të bllokut evropian, që Perëndimi të ketë qasje të re ndaj Kosovës dhe Serbisë pasi, sipas tyre, politikat aktuale nuk po funksionojnë. Ai beson se punë më e madhe duhet të bëhet në qasjen ndaj Serbisë.

Si e komentoni thirrjen e fundit të deputetëve amerikanë dhe evropianë ndaj kryediplomatëve

të Shteteve të Bashkuara, Britanisë së Madhe dhe Bashkimit Evropian, për ta ndryshuar qasjen ndaj Kosovës dhe Serbisë? Ju jeni një prej nënshkruesve të dokumentit.

Thijs Reuten: Jam jashtëzakonisht i kënaqur për këtë iniciativë, sepse jo vetëm që është thirrje përreth Atlantikut - nga deputetë prej 13 vendeve të ndryshme me nismë të Shteteve të Bashkuara, Britanisë dhe Gjermanisë - por është edhe thirrje e thënë thjesht dhe qartë. Gjithçka që jemi duke kërkuar është një qasje më e balancuar dhe më proporcionale. Po kërkojmë dy gjëra: rikthim të negociatave për normalizim, dhe ta stabilizojmë rajonin përmes një qasjeje të qartë e të koordinuar dhe jo ashtu siç e kemi parë në muajt e fundit.

Po e përmendni një qasje të re. Si

do të mund të dukej ajo?

Thijs Reuten: Fillimisht duhet dhënë fund qasjes aktuale dhe kjo ka të bëjë kryesisht me qasjen më të butë ndaj presidentit të Serbisë, Aleksandar Vuçiq, i cili, sipas mendimit tim, është duke ndikuar jo vetëm në punët e Bosnjë-Hercegovinës, duke e mbështetur presidentin e Republikës Sërpska, Millorad Dodik, por është edhe pengesë për përparim në rrugën drejt normalizimit të marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë, e cila është shumë e nevojshme. Tjetra, duhet të jemi shumë të qartë nga ajo që kërkojmë nga partnerët në gjithë rajonin. Bashkimi Evropian duhet ta kuptojë që stabiliteti i këtij rajoni është kyç për stabilitetin e gjithë kontinentit. Ne nuk mund t'i tolerojmë vetes më shumë gabime dhe një gjë që e

propozojmë si deputetë është diplomacia parandaluese.

Të flasim më shumë për këtë lloj të diplomacisë.

Thijs Reuten: Kjo nënkupton se neve na duhet një plan B, natyrisht jo për të luftuar, por për t'i bërë të qarta prioritetet tona. Kjo nënkupton përforsimin e EUFOR-it në Bosnjë-Hercegovinë, përforsimin e KFOR-it në Kosovë, nëse është e nevojshme, sidomos në rastet siç kanë ndodhur sulmet ndaj tyre, të ketë përgjigje pa dilema dhe të qartë nga ana e komunitetit ndërkombëtar.

Në të kaluarën nuk është përmendur shpesh diplomacia parandaluese. A do të jetë ajo rrugë përpara?

Thijs Reuten: Është diplomaci në kuadër të një qasjeje më të gjerë, që nuk garanton vetëm stabilitet përmes pranisë ndërkombëtare në rajon, por do të thotë edhe përgjigje ndaj krizave secilën herë që shfaqen ato. Secilën herë që dikush në rajon e minon stabilitetin dhe rrugën drejt integriteteve, duhet të reagojë. Por, kjo nuk ka

ndodhur në muajt dhe vitet e fundit, sepse i kemi lënë të kalojnë shumë incidente.

Deputetja Alicia Kearns ka thënë se është e rrallë që aq shumë deputetë jeni mbledhur për ta shprehur shqetësimin lidhur me zhvillimet e fundit në Kosovë dhe Serbi. Çfarë do të thotë kjo?

Thijs Reuten: Kjo tregon se shumë deputetë jemi të vetëdijshëm se jemi në moment kyç dhe nuk mund ta lëmë këtë çështje për trajtim as pas pushimeve të verës. Gjërat janë duke ndodhur tani dhe kjo tregon se ne duam që kryediplomatët të veprojnë dhe të ketë koordinim ndërmjet tyre.

Cilët janë tre hapat e parë që duhen ndërmarrë?

Thijs Reuten: Duhet lënë anash vetëkënaqësinë dhe qasjen e butë, dhe mendësinë e të mospërgjigjurit qartazi ndaj marrëveshjeve të kaluara. E dyta, duhet të ketë koordinim për dallim prej muajve të fundit që kemi parë tone dhe qëndrime të ndryshme sa i përket situatës në mes të Kosovës dhe Serbisë dhe ngjarjeve në Bosnjë-Hercegovinë. Së treti, duhet të

Osmani e kërkon ndihmën e ShBA-së për përshpejtimin e anëtarësimit të Kosovës në NATO

Prishtinë, 9 gusht - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, e ka kërkuar ndihmën e Shteteve të Bashkuara (ShBA) për përshpejtimin e procesit të anëtarësimit të Kosovës në Organizatën e Traktatit të Atlantikut Verior (NATO), gjatë një takimi me senatorin amerikan Jack Reed, të martën në Prishtinë.

Osmani tha më 8 gusht se ShBA-ja "nuk ka aleate dhe mike më të madhe në rajon sesa Republikën e Kosovës", duke e cilësuar popullin e Kosovës "më proamerikanin në Evropë dhe në botë".

Pas takimit me Osmanin, Reed u prit edhe nga kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, i cili e falënderoi atë "personalisht për përfshirjen e Kosovës në Aktin Fiskal të Autorizimit të Mbrojtjes Kombëtare të vitit 2024, që ia mundëson Kosovës të jetë pjesëmarrëse në ushtrime ushtarake të udhëhequra nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës për ta rritur ndërveprimin dhe përshtatshmërinë me trupat e NATO-s".

Në një njoftim për medie, zyra e kryeministrit tha: "Senatori Reed u shpreh falënderues për mikpritjen. Ai veçoi vendimin dhe vullnetin e Republikës së Kosovës për strehimin e qytetarëve afganë, duke shprehur mirënjohjen e tij. Ndër të tjera, tha se mbështetja ndaj Kosovës në vitin 1999 ka qenë një nga veprimet më të çmueshme të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, ndërkohë që vlerësoi progresin që ka arritur Kosova dhe dha mbështetjen e tij për rezultatet pozitive".

Osmani e falënderoi senatorin Reed, i cili është kryesues i Komisionit të Forcave të Armatosura në Senatit të ShBA-së, për mbështetjen e ShBA-së



për Forcën e Sigurisë së Kosovës (FSK), respektivisht përfshirjen e Kosovës në Asistencën e Trajnimit Ushtarak të ShBA-së me Ligjin e Autorizimit të Mbrojtjes Kombëtare të vitit 2024. "Kosova synon për anëtarësim në NATO dhe përfshirje në Partneritet për Paqe

(PfP), ndaj është e rëndësishme edhe e domosdoshme mbështetja e ShBA-së për përshpejtimin e këtij procesi. Shpresa jonë është që Kosova të jetë sa më parë në PfP si hap që i paraprinë anëtarësimit në NATO", tha Osmani.

Në lidhje me zhvillimet politike

dhe të sigurisë, sipas njoftimit, presidentja theksoi se Kosova ka bërë hapa për shtensionimin e situatës në veriun e vendit si dhe "ka vërë në dukje veprimet destabilizuese të Serbisë dhe bashkëpunimin e saj me Rusinë". "Ajo, po ashtu, ka theksuar se Kosova është shtet

multietnik, Kushtetuta e së cilës garanton nivel të lartë të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të të gjitha komuniteteve. Sipas presidentes Osmani, këto të drejta dhe liri janë thelbi i vlerave të shoqërisë së Kosovës dhe, si të tilla, duhet të mbeten të paprekura".

jemi më të vendosur në atë se cila është rruga përpara. Kjo do të thotë se shtetet duhet të marrin vendime të vështira. Serbia duhet të marrë vendim të qartë për Evropën, në vend të miqësisë së ngrohtë me Rusinë e [presidentit rus, Vladimir] Putin, por kjo nënkupton që edhe politikanët në Bosnjë-Hercegovinë duhet t'i caktojnë prioritetet që janë të domosdoshme për integrim në familjet evropiane. Kam qenë shumë kritikë ndaj Komisionarit për Fqinjësi të Mirë. Ai është nga Hungaria, [Oliver] Varhelyi, por edhe e gjithë BE-ja duhet të dalë me plan më ambicioz për përfshirje të rajonit. Nuk do të ndodhë përgjatë natës, as për një vit, por duhet pasur synim të qartë për të ardhmen. Gjërat duhet të ndodhin këtë dekadë dhe duhet të ndodhin shpejt.

Kur përmendni tone të ndryshme, kujt po i referoheni?

Thijs Reuten: Po u referohem përfaqësuesve të ndryshëm, ambasadorëve të ndryshëm në shtetet respektive, që me raste kanë mbështetur qëndrime të ndryshme dhe me raste kanë krijuar konfuzion. Për të dhënë një shembull, për mua ka qenë shumë e çuditshme, ndonëse i kam parasysh tensionet, që Shtetet e Bashkuara i kanë pezulluar stërvitjet ushtarake me Kosovën, mirëpo një javë më vonë i kanë zhvilluar stërvitjet me ushtrinë serbe. Edhe deklarimet e mëtejme që nuk kanë qenë gjithmonë në një linjë, kur ka qenë fjala për kidnapimin e tre policëve të Kosovës në territorin e Serbisë. Mendoj se Shtetet e Bashkuara kanë reaguar më me vendosmëri sesa

BE-ja. Diçka e tillë krijon konfuzion, andaj është e rëndësishme të ketë koordinim.

Në letër përmenden mësimet nga e kaluara dhe që të mos krijohet një politikë për Ballkanin që e ka në qendër Beogradin. Si e komentoni këtë pjesë?

Thijs Reuten: Është referencë për vitet '90 të shekullit të kaluar kur kemi menduar që me qasje të butë ndaj Beogradit, apo duke ndërmjetësuar marrëveshje, do ta gjejmë zgjidhjen. Ajo që do të duhej të mësonim sa i përket Evropës Juglindore është se ky lloj ledhimi nuk funksionon kurrë. Duhet të jemi të qartë se çfarë kërkojmë nga të dyja shtetet.

Çfarë prisni nga zyrtarët të cilëve ua keni nisur letrën?

Thijs Reuten: Pres përgjigje të

thuktë dhe të koordinuar, sepse kjo është goxha iniciativë unike. Nuk u jemi drejtuar të tria palëve aksidentalisht dhe presim politikë të re për rajonin.

Kosova ka marrë hapa drejt shtensionimit të situatës në veri. Siç është përmendur edhe në marrëveshjen e arritur në mes të Kosovës dhe BE-së në Bratisllavë, Policia e Kosovës e ka zvogëluar praninë në veri dhe zyrtarët e Kosovës kanë thënë se janë të përkushtuar për organizim të zgjedhjeve të reja. Pse nuk po i heq BE-ja sanksionet ndaj Kosovës?

Thijs Reuten: Kam qenë shumë kritik për këtë gjë në disa takime në Parlamentin Evropian. Sipas mendimit tim, bazuar në kërkesat e BE-së, të datës 3 qershor, Kosova ka treguar

gatishtëri për t'i zbatuar të gjitha pikat. Problemi tani është që e kemi një situatë në favor të presidentit Vuçiq, sepse ai tani mund të bëjë hapa mbrapa dhe ta vazhdojë lojën e tij, që nuk e ka në fokus përparimin, por mbajtjen e situatës jostabile. Dy gjëra duhet të ndodhin: fillimisht rikthimi i dialogut, më pas që të dyja vendet duhet të fokusohen në zgjedhjet e tyre për t'iu afruar integriteteve. Po dëgjoj shumë kritika se grupi nënshkrues është armik i Serbisë. Kjo nuk është aspak e vërtetë. Nuk ka asgjë më të mirë për rajonin sesa që Serbia të zgjedhë të ardhmen evropiane. Kjo është gjëja më e mirë që mund t'i ndodhë BE-së dhe rajonit. Ne nuk jemi armiq, por duam ndryshim të qartë të politikës, e cila duhet të jetë e balancuar dhe proporcionale.

Osmani dekreton guvernatorin e ri të Bankës Qendrore të Kosovës

PRISHTINË, 9 GUSHT - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, pas vendimit të Kuvendit të Kosovës, ka dekretuar guvernatorin e ri të Bankës Qendrore, Ahmet Ismaili. Ajo e ka uruar Ismailin për përzgjedhjen nga Kuvendi i Kosovës,

duke i dëshiruar suksese në realizmin e detyrave dhe përgjegjësi të cilat burojnë nga kjo pozitë e rëndësishme. Sipas presidentes Osmani, Kushtetuta, ligjet, integriteti dhe profesionalizmi duhet të jenë udhërrëfyes

përgjatë punës në institucionet shtetërore. Ndërkaq Ismaili ka paraqitur vizionin e tij për BQK-në si dhe nxitjen e rritjes së qëndrueshme të bazuar në përkushtimin ndaj shërbimit publik, efikas dhe transparent.



Policia fillon ta zbatojë planin operativ 'Goditja'

Prishtinë, 9 gusht - Policia e Kosovës, me qëllim të shtimit të masave të sigurisë, respektivisht ruajtjen e rendit e qetësisë publike, ka hartuar dhe që nga sonte ka filluar ta zbatojë një plan operativ i cili do të shtrihet në tërë vendin.

Detyrat që parashihen të realizohen gjatë zbatimit të planit operativ 'Goditja' janë shtimi i aktiviteteve/patrullimeve policore, kryesisht në qendra urbane, në ato pjesë ku ka më shumë lokale, kafiteri, bare nate e më shumë qytetarë që i vizitojnë ato.

Policia do të ketë bashkëpunim me organet e drejtësisë për aktivitetet dhe për trajtimin e rasteve eventuale që mund të inicohen gjatë zbatimit të këtij plani.



Policia do të trajtojë në aspektin qytetarët dhe informatat parandalimit të rasteve e akteve policor çdo informatë nga inteligjente, me qëllim të kriminale. Do të shtohen

kontrollat policore ndaj personave e automjeteve me qëllim të gjetjes dhe konfiskimit të gjërave të ndaluara, me theks të veçantë armëve dhe mjeteve të tjera të rrezikshme për jetën.

Policia, duke e pasur parasysh se suksesi i operacioneve policore varet nga bashkëpunimi me qytetarët, i fton të gjithë qytetarët që për çdo gjë të dyshimtë që vërejnë ta lajmërojnë policinë sepse çdo informatë e dhënë mund të parandalojë një akt kriminal ku mund të rrezikohen jeta dhe siguria publike.

Policia mbetet e përkushtuar për kryerjen e detyrave me profesionalizëm dhe integritet me qëllim të arritjes së qëllimeve strategjike dhe ofrimit të një shërbimi sa më efikas për qytetarët dhe vendin.

Kosova ndan rreth 255 000 euro për tekstet shkollore për Luginën e Preshevës



PRISHTINË, 9 GUSHT - Qeveria e Kosovës ka ndarë të mërkurën 254 562 euro për tekstet shkollore në gjuhën shqipe për filloristët shqiptarë që jetojnë në tri komunat në jug të Serbisë.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, tha se edhe vitin e kaluar ekzekutivi i Kosovës ka ndarë mjete për tekstet shkollore, ndërsa për vitin e ri shkollor do ta bëjë të njëjtën gjë për nxënësit në Preshevë, Medvegje dhe Bujanoc. "Vitin e kaluar kemi ndarë [mjete financiare] me qëllim të pajisjes me tekste mësimore në gjuhën shqipe për nxënësit shqiptarë të shkollave fillore në Preshevë, Medvegje dhe Bujanoc. Ndihami jonë për bashkëkombësit tanë është jo vetëm nevojë, por edhe obligim yni që t'i mbrojmë të drejtat e tyre elementare", tha ai. Kërkesa për ndarjen e këtyre mjeteve është bërë nga Këshilli

Kombëtar Shqiptar. Ky këshill edhe më herët ka kërkuar që komuniteti shqiptar në Serbi të ketë të drejta të njëjta që gëzon komuniteti serb në Kosovë.

Në mesin e këtyre të drejtave është përmendur edhe sigurimi i teksteve shkollore në gjuhën shqipe, duke argumentuar se komunitetit serb në Kosovë i lejohet përdorimi i materialeve mësimore nga Republika e Serbisë.

Përfaqësuesit e Preshevës, Medvegjes dhe Bujanocit - komuna që njihen edhe me termin Lugina e Preshevës - shpesh janë ankuar se diskriminohen nga autoritetet në Serbi.

Sipas regjistrimit të fundit të popullsisë, shqiptarët janë pakica e katërt më e madhe në Serbi, përkatësisht në këtë shtet jetojnë 61 687 shqiptarë.

Qeveria miraton projekt-udhëzimin për ndalimin e pjesëmarrjes së fëmijëve në klubet e natës

PRISHTINË, 9 GUSHT - Qeveria e Kosovës ka miratuar projekt-udhëzimin administrativ për ndalimin e pjesëmarrjes së fëmijëve në klubet e natës.

Në mbledhjen e qeverisë, zëvendësministri i Punëve të Brendshme, Bardhyl Dobra, gjatë fjalës së tij tha se fryma e këtij projekt-udhëzimi është

mbrojtja më e mirë e fëmijëve. "Fryma e këtij projekt-udhëzimi është mbrojtja më e mirë e fëmijëve duke ndërtuar mekanizma përgjegjës nëpërmjet caktimit të autoriteteve publike nga policia, shërbimet sociale deri tek obligimet e prindërve, kujdestarëve, pronarëve të

bizneseve dhe personave përgjegjës karshi marrjes së masave të nevojshme për ndalimin e pjesëmarrjes së fëmijëve në klubet e natës dhe ekspozimit të tyre në këto situata të papërshtatshme që mund ta prekin jetën, dinjitetin dhe mirëqenien e fëmijëve...", ka thënë Dobra.



Deliu: Me bekimin e Radojçiqit qeveria 'Zdravo' po emëron zyrtarë që cenojnë karakterin e shtetit të Kosovës

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 9 GUSHT - Deputetja e Kuvendit të Kosovës nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Blerta Deliu-Kodra, ka thënë se emërimi i Radoica Radomiroviqit drejtor në komunën e Leposaviqit, e cenon karakterin e shtetit dhe institucioneve publike të Kosovës.

Në një konferencë për medie, Deliu-Kodra tha se ky emërim i të birit të Nikolla Radomiroviqit, ushtar i ushtrisë serbe deri vonë në Rashkë, dëshmon se tashmë afëra "Zdravo" nuk është thjesht një aferë e simpatisë në mes të Listës Serbe dhe Albin Kurtit. "Dje mediet raportuan edhe për një aderim të ri në institucionet e udhëhequra nga pushteti: Lulzim Hetemi, kryetari i Leposaviqit nga Vetëvendosje, e ka emëruar drejtor të birin e Radoica Radomiroviqit, Nikolla Radomiroviq, ushtar i ushtrisë serbe deri vonë në Rashkë. Siç po e shihni, tashmë afëra 'Zdravo' nuk është thjesht një aferë e simpatisë në mes të Listës Serbe dhe Albin Kurtit, por është aferë që ka implikime direkte në shoqërinë dhe në shtetin tonë, mbi të gjitha në vetë karakterin e shtetit tonë. Para disa ditësh në medie doli një intervistë e ish-deputetit të Listës Serbe, Slavko Simiqi, i cili, në përgjigje ndaj, "kinse padisë" nga ana e Mimoza Kusarit për përgjimet e aferës 'Zdravo', i nxori edhe disa pretendime

jashtëzakonisht shqetësuese, për të cilat konsiderojmë se duhet të jenë të shqetësuar të gjithë qytetarët e Kosovës. Në mes të tjerash, u pa qartë se koordinimi në mes të Albin Kurtit dhe kriminelit Milan Radojçiq është koordinim shumë më i thellë e më i fortë sesa përpjekjet idioeteske të koalicionit 'Zdravo' për ta minimizuar atë", theksoi ajo.

Sipas Deliu-Kodrës, u pa qartë se nga takimet e rregullta e të njëpasnjëshme të Kusarit me Simiqin, qeveria "Zdravo" ka zgjedhur njerëz nëpër institucione publike me bekimin e kriminelit Radojçiq. "Nga Simiqi mësuam se Radojçiqi e ka mbështetur qeverinë 'Zdravo' të Albin Kurtit për shkak se përmes saj ai ka realizuar interesat kombëtare të Serbisë. Paramendoni, kemi një qeveri e cila, duke shkelur mbi karakterin e shtetit, i akomodon interesat kombëtare të Serbisë përmes koordinimit me një kriminel ordiner si Milan Radojçiq. Kjo është ajo çfarë na shqetëson dhe duhet të na shqetësojë të gjithëve. Dhe për fund, kuptuam, po ashtu, se Mimoza Kusari, protagonistja e aferës 'Zdravo', në fakt paska mundësi të jetë protagoniste edhe e shumë përgjimeve të tjera për të cilat paralajmëroi Simiqi, gjë që dëshmon qartë se ne dhe qytetarët e Kosovës mund të kemi parë vetëm një pjesë fort të vogël, të llumit të madh anti-shtetëror,



antikombëtar e anti-institucional, në të cilën janë të përfshirë qeveria 'Zdravo', Albin Kurti dhe Mimoza Kusari", theksoi ajo.

PDK-ja kërkon nga organet e rendit ta hetojnë secilën veprimtari të protagonistëve të aferës "Zdravo", kurse nga organet e sigurisë sonë kombëtare të sigurohen se përgjegjësit në krye të institucioneve publike, ata që

janë emëruar nga Albin Kurti me bekimin e Radojçiqit, të mos jenë duke kryer ndonjë akt antikombëtar e anti-shtetëror për interesat kombëtare të Serbisë në Kosovë, të cilat interesa sot mbrohen e realizohen përmes Albin Kurtit, Mimoza Kusarit e Milan Radojçiqit.

Po ashtu, deputetja Deliu-Kodra ka kërkuar mbajtjen e zgjedhjeve të jashtëzakonshme, për ta

ndaluar degradimin e vendit nga qeveria Kurti. "E përsërisim edhe një herë se katandisja e përgjithshme e vendit nga qeveria 'Zdravo' është duke iu kushtuar qytetarëve në çdo drejtim, prandaj ne duam zgjedhje të jashtëzakonshme në mënyrë që qytetarët ta ndalin rrugën e turpit, degradimit e shthurjes së çdo gjëje që 'Zdravo' qeveria e ka nisur tash e gati tri vjet", shtoi deputetja Deliu.

Shërbime të reja dhe investime infrastrukturore në Klinikën e Gjinekologjisë

EPOKA
ERE

F. DËRMAKU

PRISHTINË, 9 GUSHT - Ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, bashkë me drejtorin e ShSKUK-së, Elvir Azizi, kanë vizituar dje Klinikën e Gjinekologjisë, në të cilën janë pritur nga drejtori i kësaj klinike, Zef Ndrejaj dhe stafi i profesionistëve shëndetësorë. Ministri Vitia tha se bosht i prioritetit në shëndetësi do të jetë shëndeti i nënës dhe fëmijës. "Në këtë drejtim, pas ndërtimit të Klinikës së Pediatrisë, është parë si i domosdoshëm intervenimi në Klinikën e Gjinekologjisë ku marrin shërbime dhe sjellin në jetë shumë foshnja gratë dhe vajzat tona. Ato meritojnë kushte të dinjitetshme dhe për këtë arsye që nga fillimi Klinika e Gjinekologjisë është prioritet i investimeve", tha i.

Ministri i Shëndetësisë i njoftoi të pranishmit se do të fillojnë investimet në infrastrukturë dhe në përmirësimin e kushteve për pacientët në Klinikën e Gjinekologjisë. Gjithashtu, edhe



sa i përket Fekondimit të Asistuar Mjekësor (FAM), ai i njoftoi se procedurat janë në finalizim në mënyrë që ky shërbim të ofrohet deri në fund të vitit. Ai veçoi edhe projektin e "Mjekësisë Fetale". "Ju përgëzoj për punën e jashtëzakonshme që është bërë

në këto kushte. Tani e tutje, me trajnimet, donacionet dhe investimet që do t'i bëjmë edhe ne si MSh, por edhe ShSKUK, Njësia e Mjekësisë Fetale si pjesë shumë e rëndësishme për shëndetin e nënës dhe fëmijës do të jetë në një stad tjetër. Do të

ndikojë dukshëm në detektimin e hershëm të patologjive të ndryshme të foshnjat gjatë periudhës së shtatzënisë së nënës", tha ministri Vitia.

Drejtori i Klinikës së Gjinekologjisë, Zef Ndrejaj, e informoi ministrin Vitia se në

Klinikën e Gjinekologjisë kanë arritur dy pajisje mjekësore, ultratinguj në vlerë të rreth 150 mijë euro, donacion nga "Fondi për Mjekësi Fetale" me seli në Londër. Ministri Vitia i falënderoi për këtë investim si dhe për gatishmërinë që në të ardhmen ta financojnë edhe rregullimin e infrastrukturës në pjesën ku do të themelohet Njësia e Mjekësisë Fetale.

Ky program u bë i mundur pas nënshkrimit të memorandumit të bashkëpunimit me Zyrën Ndërlidhëse të Greqisë në Kosovë dhe Fondacionin për "Programin e Mjekësisë Fetale për periudhën 2022-2025".

Përgjatë kësaj kohe janë zhvilluar trajnime praktike çdo ditë në kuadër të programit njëvjeçar në Obstetrikë - Ekografi dhe Mjekësi Fetale si subspecializim apo profil i ngushtë. Respektivisht janë organizuar trajnimet për rastet kur një grua ose foshnja e palindur mund të kërkojë kujdes të specializuar për të arritur rezultate më të mira për shëndetin e nënës dhe fëmijës.

LDK-ja kërkon hetim parlamentar për rezervat shtetërore

PRISHTINË, 9 GUSHT - Partia opozitare, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), ka kërkuar formimin e një komisioni parlamentar hetimor për kontratat që Ministria e Tregtisë, Industrisë dhe Ndërmarrësisë (MINT) ka bërë për rezervat shtetërore.

Arben Gashi, shef i grupit parlamentar i LDK-së, në një konferencë për medie tha se në mbledhjen e parë të sesionit vjeshtor të Kuvendit do të kërkojnë formimin e këtij komisioni. "Qytetarët e Kosovës kanë nevojë të dinë të vërtetën. E vërteta është zgjidhja e duhur. Keqpërdorimet dhe abuzimet eventuale aktuale me rezervat shtetërore kërkojnë qasje hetimore, serioze dhe përmbytësore", tha Gashi më 9 gusht. Sipas tij, përveç hetimeve penale që duhet t'i bëjë Prokuroria e Shtetit, është e

domosdoshme të bëhen edhe hetime parlamentare për të parë, siç tha Gashi, "se a janë respektuar ligjet dhe procedurat për rezervat shtetërore".

Kërkesa për hetim parlamentar nga LDK-ja vjen pas publikimit të disa audio-incizimeve nga portali "Nacionale", ku flitet për keqpërdorime të kontratave për blerjen e rezervave shtetërore nga MINT-i.

"Nacionale" ka raportuar për importimin e grurit me çmim më të shtrenjtë nga një kompani ndërtimi në Turqi. Ky portal ka bërë me dije se kompania turke ende nuk e ka sjellë në Kosovë sasinë e grurit për të cilën ka paguar Qeveria e Kosovës.

Në Kosovë në vitin 2010 është miratuar Ligji për Rezervat Shtetërore. Sipas këtij ligji, rezervat shtetërore të mallrave krijojnë për të ndërhyrë në



mënyrë operative për mbrojtjen e popullsisë, ekonomisë në rast të çrregullimit të tregut, mbrojtjes së vendit në situata të gjendjes së jashtëzakonshme, gjendjes së emergjencës civile dhe shumë raste të tjera të ngjashme.

Rezervat shtetërore të mallrave sigurohen në bazë të planit strategjik afatmesëm, kurse administrohen nga

Departamenti i Rezervave Shtetërore të Mallrave në kuadër të Ministrisë së Tregtisë, Industrisë dhe Ndërmarrësisë. Ndryshe, sipas ligjeve në fuqi, komisionet hetimore themelohen për të hetuar probleme, çështje ku janë drejtpërsëdrejti të përfshira përgjegjësitë qeveritare apo shtetërore. Këto organe, po ashtu, ngrihen me qëllim të konstatimit, për-

shkrimin të rrjedhës së ngjarjeve apo me qëllim të qartësimin të asaj çfarë ka ndodhur dhe përcaktimit të përgjegjësisë së atyre që kanë qenë të përfshirë. Sipas Ligjit për Hetim Parlamentar, komisionet hetimore kanë qëllim edhe për informim, rekomandim dhe ushtrim të mbikëqyrjes parlamentare dhe të arritjes së një përfundimi.

Bankat në Kosovë fituan mbi 65 milionë euro për pesë muaj

Prishtinë, 9 gusht - Në Kosovë bankat komerciale kanë ecuri tejet pozitive është thënë në një raport të Bankës Qendrore të Kosovës (BQK). Sipas këtij raporti, vetëm deri në maj të 2023-s bankat kanë arritur të sigurojnë profit neto 65 milionë euro.

BQK-ja ka theksuar se këto fitime të mëdha vijnë si rezultat i normave të larta të interesit në kredi si dhe nga tarifat e larta të shërbimeve (të hyrat nga jointerisi), të cilat në vitin 2022 pothuajse të gjitha janë rritur në emër të inflacionit të lartë që po mbretëron në Kosovë dhe rajon.

Në raport është thënë se në muajin maj të hyrat totale në këtë sektor ishin në vlerë të



157.5 milionë eurove.

Prej tyre, gjithsej 118.1 milionë ishin të hyra vetëm nga interesi.

Ndërsa shpenzimet totale të këtij sektori për këtë periudhë ishin 91.6 milionë, kurse shpenzimet për interes ishin

në vlerë të vetëm 13.3 milionë eurove. Ndërkohë, normat efektive të interesit në muajin maj mbetën në vlerën 6.5 për qind.

Norma e interesit për kreditë e dhëna për ekonomitë familjare në këtë periudhë ishte 6.1

për qind njësoj si në prill, kurse për ato konsumuese kanë mbetur njësoj si në prill 6.5 për qind. Sipas këtij raporti, kreditë për korporatat jofinanciare janë rritur në 6.8 për qind nga 6.5 për qind sa ishte në muajin prill të këtij viti.

Në anën tjetër, vlera totale e shumës së dhënë për kredi deri në muajin maj të këtij viti ka arritur në 4 miliardë e 643.3 milionë euro nga 4 miliardë e 562.8 milionë euro sa ishte vlera në prill. Prej gjithë kësaj shume, 1 miliard e 747.2 milionë euro ishin kredi për ekonomitë familjare, 2 miliardë e 864.9 milionë të tjera për korporatat jofinanciare dhe 15.6 milionë euro për korporatat e tjera financiare. Kurse depozitat e qytetarëve

të ruajtura nëpër bankat komerciale në vend, deri në fund të muajit maj 2023, arritën në 5 miliardë e 604.3 milionë euro, nga 5 miliardë e 575 milionë sa ishte vlera e tyre në prill. Aktualisht vlera totale e aseteve të sektorit bankar në vend është 6 miliardë e 806.4 milionë euro.

Kujtojmë se edhe gjatë vitit 2022 fitimi neto i këtyre institucioneve bankare në vend kishte shkuar mbi 140.3 milionë euro, duke e tejkaluar kështu mesataren disavjeçare që zakonisht ishte përmbyllur me nga 80-100 milionë euro. Në Kosovë aktualisht janë duke operuar gjithsej 12 banka komerciale, 9 prej të cilave janë banka me kapital të huaj.

Ministri Peci: Do të ekzekutohen rreth 30 milionë euro pagesa për subvencione dhe grante

"Epoka e re"

PRISHTINË, 9 GUSHT - Ministri i Bujqësisë, Faton Peci, në një konferencë për medie ka folur të mërkurën për zhvillimet në sektorin e bujqësisë. Ai ka treguar se në mbledhjen e fundit të qeverisë është miratuar Projektligji për Ratifikimin e Marrëveshjes në mes të Republikës së Kosovës, të përfaqësuar nga Ministria e Bujqësisë dhe Agjencisë Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ) lidhur me projektin "Mbështetja për zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit të bujqësisë në zonat rurale përmes diversifikimit të

aktiviteteve". "Ky projekt ka për qëllim diversifikimin e fermave dhe aktiviteteve alternative në zonat rurale në Kosovë. Ratifikimi i kësaj marrëveshjeje do të mundësojë rritjen e punësimit në zonat rurale përmes krijimit të mundësive të reja të punës ose vetëpunësimit dhe ruajtjen e vendeve të punës ekzistuese nëpërmjet zhvillimit të aktiviteteve të agro-biznesit, duke kontribuar kështu në qëndrueshmërinë e fermës dhe ngritjen e aktivitetit agro-ekonomik në po ato zona rurale", ka thënë Peci, duke shtuar se në mbledhjen para-prake të qeverisë kanë aprovuar PKBZhR - 2023 -

2027. "Javën që vjen aprovohet Programin Vjetor të Granteve për vitin 2023, ndërsa deri në fund të javës do të ekzekutohen rreth 30 milionë euro pagesa për subvencione dhe grante. Gjithashtu, është aprovuar nisma për fillimin e negociimit për Marrëveshjen me Bankën Botërore dhe Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve për Projektin e Përmirësimit dhe Rindërtimit të Sistemeve të Ujitjes, projekt ky i cili do të implementohet nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural", ka thënë ai, duke treguar se vlera e këtij granti është 9.15 milionë euro. "Kjo shifër do ta rrisë efikasitetin e përdorimit



të ujit dhe ta nxisë produktivitetin bujqësor në zonat ku do të zhvillohet projekti. Ky projekt ka synim përmirësimin dhe modernizimin e shërbimit të ujitjes, uljes së humbjeve të ujit dhe kostos së

prodhimit, si dhe për ta rritur produktivitetin bujqësor", ka thënë ministri i Bujqësisë. Ai ka bërë me dije se janë gjithsej 20.2 milionë euro për agroturizëm, ekoturizëm dhe zhvillim rural.

LETËRNJOFTIMI I MUHAMET GASHIT

Nga: Violeta GASHI

Shqiponjat, në tokën e tyre kanë qenë gjithmonë t'shkelura e të shkelura nga çizme të ndryshme. Mirëpo edhe pse kanë pasur shkelje e Shkelje, nuk i humben Traditat dhe Kulturën e tokës së tyre. Po ashtu gjatë shkeljeve, për të jetuar shumë shqiponjave i duhej ta ndërrojnë vendlindjen me një tokë tjetër.

Shqiponjat, ndërrimin e tokës e bënin qoftë në afërsi të vendlindjes e qoftë në diasporë. Mirëpo edhe pse kthenin timonin, nga një vend në vendin tjetër nuk e ndryshuan asnjë tipar të Shkëlqyer të tokës së tyre. Kështu disa shqiponjave nga Buzhala e madhe e Tropojës, i duhet patjetër për të shpëtuar nga shkelja e çizmeve gjakpirëse ta ndërrojnë vendlindjen me tokën e Kusurijit të Pejës më 1873-ën, apo më 1874-ën.

Shqiponjat, jetuan në këtë tokë për Bukuri pasi vendi kishte bukuri e Bukuri natyrore por shkelja e çizmeve prapë i Detyroi ta ndërrojnë këtë Bukuri natyrore. Kështu disa shqiponja n'fis dhe n'mbiemër Gashë, më 1878-ën kthyen timonin për t'jetuar në Jashanicë të Klinës e pas dy vjetëve prapë ndërrojnë vendin dhe shkuan në Zaberxh për t'jetuar pasi iu dukej ma qetë. Disa shqiponja n'fis dhe n'mbiemër Gashë, vuanin e Vuanin jo vetëm nga shkelja e çizmeve por edhe nga rrethanat që i përjetonin me rastin e ndërrimit të tokës. Kështu më 1900-ën disa shqiponja n'fis dhe n'mbiemër Gashë, për të jetuar kthejnë timonin e jetës në Murgë. Mirëpo edhe këtu edhe pse toka si në të gjitha vendet kishte një Bukuri natyrore të rrafshët, iu duhet ta kthejnë timonin nga Murga në Gullubofcë për t'jetuar e pikërisht këtë kthim të timonit e bëjnë më 1905-ën.

Toka e Gullubofcë, si tokat e vendeve të lartëshkruara kishte një bukuri natyrore dhe t'rrafshët. Mirëpo disa shqiponja n'fis dhe n'mbiemër Gashë, nga shkeljet e çizmeve gjakpirëse dhe nga rrethanat iu duhet ta ndërrojnë vendlindjen me fshatin e Bukurisë natyrore dhe të rrafshët Gurikuq apo ish-Plloçicë e këtë ndërrim t'vendqëndrimit e bën më 1907-ën.

Toka e fshatit Gurikuq, përveç cilësive të lartëshkruara kishte edhe një cilësi të pa zëvendësuar e kjo Cilësi ishte pasi po të hidhej fara mbrapsht në tokë binte mbarë.

Disa shqiponja n'fis dhe n'mbiemër Gashë, edhe pse kishin Peripeti nga shkeljet e çizmeve të ndryshme nuk kthyen timonin më në asnjë vend tjetër sot e asaj dite. Ndërsa brezat e rinj, për t'ecur në hap me kohën gjejnë çati të përkohshme sa ma afër hapit të suksesshëm. Madje disa shqiponja n'fis dhe

n'mbiemër Gashë, kthejnë timonin për të jetuar me hap përpara n'vende sa më të afërta n'përhershmeri me hapin e përparshëm n'kohë dhe në sukses. Mirëpo çatit e Çatit n'fshatin Gurikuq, s'i prishin pasi duan ta Ruajnë vendin e etërve dhe pasi nga 09-ta s'kanë më shkelje t'çizmeve gjakpirëse. Kështu Çatit e tokës së Shkëlqyer të fshatit Gurikuq, disa shqiponja n'fis dhe n'mbiemër Gashë i kanë si Çati turistike dhe si Çati ku mbajnë ahengje kur kthehen nga vendet ku jetojnë me timonin e Shkëlqyer.

Letërnjoftimi i Muhamet Gashit

Muhamet Gashi, ka lindur më 05.V.1940 në fshatin Gurikuq apo ish-Plloçicë nga nëna Nazë dhe nga babai Sokol.


Lindja e Muhamet Gashit, kishte qenë e ndryshme nga fëmijët e barkut të Nazës, sepse kishte një dashuri të zjarrtë për librin dhe me këtë dashuri pasi mbaroi katër vjeçarën e asaj kohe sa sot një shkollë e lartë filloi ta përhapte njohurinë tek secili-a pasi kishte ketë lindje që ta shihte tjetrin-ën si vetën.

Kështu më 1953-ën, gjer më 1957-ën, kishte dhënë mësim n'fshatrat afër vendlindjes. Mësimin e zhvilloi nëpër kulla, ku ditën mësonte gjinin femërore e natën mësonte gjinin mashkullorë.

Kullo-klastë e Muhamet Gashit, gjatë mësimit kishin afër pesëdhjetë nxënës të moshave të ndryshme e në këta nxënës kishte edhe më të vjetër se sa vetë mësuesi.

Mirëpo të dy gjinitë Muhamet Gashin, respektonin e Respektonin pasi përveç mësimit i ndihmonte edhe në anën financiare e kështu më tepër Muhamet Gashit i qëndronin para syve këta nxënës t'gjinisë mashkullorë:-Alush Veseli, Ramadan Malaj, Arif Haxhiu dhe Habib Sejdiu. Ndërsa para syve n'gjinin femërore, i qëndronin këto nxënës:-Bika Maloku, Hasime Gashi, Hamide Gashi, Hyra Gashi dhe Mehreme Gashi. Muhamet Gashit, pas vjetëve të lartë shkruara ia ndalojnë mësim dhënien çizmet gjakpirëse dhe sheh që jo vetëm fëmija e tij por fshati dhe tërë fshatrat afër kishin nevojë për anën financiare e madje shpesh s'kishin pasur as bukë për të ngrënë. Kështu Muhamet Gashi, ia vëri vetit synimin e A-Zh-së dhe kishte marrë rrugën e gurbetit pa dëshirën e tij. Sepse ai kishte dëshirë e Dëshirë t'jetonte, vetëm në tokën e shqiponjave pasi guri rënd peshon në vend të vetë.

Synimin Muhamet Gashi, kishte Dëshirë ta praktikonte e Praktikonte dhe vendosi që të shkante në gurbet por t'vinte sa ma shpesh tek gjiri familjar.



Kështu filloi punën në Zagrep, dhe punoi tri vjetë e nga këtu punoi në Shkup po ashtu tri vjetë. Pastaj punoi pesë apo gjashtë vjetë, në Gjermani e në Zvicërr. Ndërsa pas këtyre vendeve, kishte shkuar në Austri dhe në Gjermanin Lindore e që në të dy vendet kishte punuar nga dy vjetë. Pastaj Muhamet Gashi, kishte punuar edhe në Australi e në ketë vend i ndahet toka më 1981-ën për të jetuar përgjithmonë.

Kjo ndarje e tokës nga australianët Muhamet Gashit, iu bë për shkak që kishte një lindje dhe njohuri të veçantë si dhe për shkak që kishte dhjetë fëmijë në Kosovë e që t'i kishte më afër fëmijët. Mirëpo Muhamet Gashi, ia kishte vërë vetit synim A-Zh-në jo vetëm për anëtarë familjarë dhe fshatin por edhe për të gjitha fshatrat afër vendlindjes së tij. Kështu nuk pranoi tokën në Australi, dhe dokumentet kishin mbetur në Beograd. Pastaj pasi punoi këtu dy gjer në tri vjet, shkon për të punuar në Riekë e në ketë vend punoi gjersa e zuri muri më 1986-ën, dhe pas një shërimi primar të Riekës e sjellë në shtëpi djali i mikut apo Hamëz Bytyqi nga Abria.

Sjelljen në shtëpi të Muhamet Gashit, djali i mikut e bëri me mjaft vështirësi pasi rruga kishte çizme gjakpirëse dhe pasi shtati i tij përveç fytyrës kishte gipsin. Kështu shërim pas shërimi Muhamet Gashi, kujtonte vendet e ndryshme të punës në diasporën që dheun ka baltë e jo mjaltë si vendlindja dhe të gjithë fëmijët e tij çuditësin sa shpesh iu vinte babai nga gurbeti.

Madje çuditësin edhe fshatrat afër fshatit Gurikuq si dhe vetë fshati çuditej, sepse nuk shkante muaji pa marrë dhurata të çmuara nga Muhamet Gashi.

Mirëpo dhuratë më të çmuar anëtarë familjarë dhe fshati si dhe fshatrat afër vendlindjes,

merrnin nga Muhamet Gashi pasi ai iu dhuronte me kënaqësi njohuri si nga ana gjeografike e po ashtu edhe nga ana historike qoftë për tokën e shqiponjave e po ashtu edhe për tokën e diasporës. Madje dhuratë të çmuar kishin marrë edhe vendet e ndryshme të diasporës, sepse Muhamet Gashi me secilin-ën që kishte qëndruar si gjatë punës e po ashtu gjatë kohës së lirë i kishte parë si vetveten.

Shikimi i Muhamet Gashit, kishte bërë diasporën që t'mos e pengonte e as Pengonte Dëshirën e tij për të ardhur në gjirin familjar. Mirëpo Muhamet Gashi, s'kishte qenë plotësisht i kënaqur me arritjen e tij dhe kështu luftonte me sëmundje vetëm e vetëm t'mos vdiste pa përhapur akoma njohuri tek secili-a.

Dhembja trupore, shpesh e linte në shtratë por kur është ngritur nga shtrati s'pushonte n'mësimdhënie të çdo ane ndaj secilit-ës që shihte afër. Kështu më 1991-ën, dy fëmijë i kishin pasur fatkeqësi në komunikacion dhe Muhamet Gashi që të shkoi sa ma parë tek fëmijët hyri në traktor së bashku me bijën e tij apo fluturën mbretërore pasi t'mirat e tij i kishin harruar edhe vetë fëmija e vëllaut. Mirëpo shoferi apo dhëndëri i kojshtës i ardhur në fshatë, kishte vozitur shpejt dhe Muhamet Gashi përplasat afër timonit ku edhe e çanë pak buzën e poshtme.

Buza i infektohet, nga cigarja dhe i shkaktohet tomor. Pastaj pasi i shërohen fëmijët, shkon tek djali i dytë apo pëllumbi shpetues në Zvicërr për t'u shëruar pasi mjekësia kosovare ishte e dobët.

Zvicërra, ta shërojnë plotësisht ia largojnë të gjithë dhëmbët nga goja.

Muhamet Gashi, kthehet nga Zvicërra dhe prapë kënd e shihte

që kishte nevojë për njohuri të çdo lëmie me kënaqësi ia dhuronte. Kështu erdhi marsi i 2008-ës, dhe iu ndanë djemtë që t'kishin sa ma afër çdo gjë dhe që t'ia bënin me dije babait se si po iu ndahen katër bijtë. Mirëpo Muhamet Gashit, përveç tensionit që i kishte mbetur nga rasti i çarjës së buzës iu shkaktua edhe diabeti nga vuajtja shpirtërore edhe pse bijtë e tij ia afronin A-Zh-në. Pastaj pas diabetit, iu lajmërohet edhe tomori femror dhe gjendja e tij gjithmonë e më tepër keqësohet. Kështu djali i tretë apo shtylla smeralde, nuk arrinte nga fshati t'kujdesët plotësisht për babain pasi punonte në Kirurgji t'Prishtinës si kryeinfermier dhe vendosi që t'largohet nga fshati Gurikuq për të jetuar përgjithmonë në Bresje afër Fushë Kosovës.

Mirëpo plakut, iu kishin bërë shumë pika e pika-pika mbushët pusi. Kështu pikat munden plakun, edhe pse kishte një lindje të veçantë dhe një shpirt të pastër. Pastaj pikat, më 27.1.010 e sollën plakun n'operim n'Prishtinë.

Operimin n'Prishtinë, pranoi edhe pse bijtë ia kishin përgatitur të gjitha dokumentat për në Zvicërr e pikërisht n'përgatitjen e dokumentave kishte shkëlqyer djali i madhë apo Ylli orjentues. Mirëpo operimin, pranoi duke u bazuar tek djali i tretë dhe tek mjekët tanë që pas luftës ndoshta kanë më tepër njohuri si dhe tek gruaja e tek të gjithë fëmijët që do ta ndihmojnë.



Operimin Muhamet Gashi apo plaku, kaloi dhe duket që po shërohet por jo sepse operimit i ka shpetuar fal shpirtit të Pastër dhe Zotit e ky shpirt e mbajti gjallë gjer më 07.IV.010 edhe pse kishte mjaft Vuajtje si nga ana fizike e po ashtu nga ana shpirtërore.

Shpirti Muhamet Gashin, e lëshoi n'mesin e të gjithë fëmijëve dhe gruas si dhe rejave më 07.IV.010 afër orës njëzetë e dy. Kështu n'ora tre, të datës tetë nënën nga Bresja për në Gurikuq të gjithë së bashku me babain kufomë të Lulëzuar e lulëzimin e kufomës e filloi djali i katër apo Syshkruari me Lotë n'sy por pa britmë.

Lulëzimin kufomës, ia kishin Dhuruar i madh e i vogël si nga fshati e po ashtu nga shumë anë të Kosovës.

Lulëzimin ndaj Muhamet Gashit, të gjithë e bën jo vetëm n'varrim por edhe n'pesë ditë ngushëllimi që ua caktoi hoxha. Mirëpo Lulëzimin ndaj Muhamet Gashit, sot e asaj dite e vazhdojnë tek bijtë dhe bijat qoftë në Bresje e Prishtinë dhe qoftë në Malas apo ish-Malishevë e Zvicërr si dhe në Gjakovë e Llap.

Shkroi dhe korrektoi:
Violeta Gashi



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Çeku priti në takim katër medalistët e Kosovës në Lojërat Frankofone Kinshasa 2023

PRISHTINË, 9 GUSHT - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Hajrulla Çeku, së bashku me zëvendësministren Daulina Osmani, pritën në takim katër medalistët e Kosovës në Lojërat Frankofone, në Kinshasa të Republikës Demokratike të Kongos. Ministri i përgjizoi

xhuidistët Shpat Zeka dhe Dardan Cena, atletët Muhamet Ramadani dhe Gresa Bakraqi si dhe trajnerët e tyre për sukseset e arritura si dhe u shprehu mirënjohje për angazhimin dhe përkushtimin për fitore. Ministri Çeku gjithashtu falënderoi

zëvendësambasadorin e Francës në Kosovë, Francois Cyprien, për mbështetjen e qeverisë franceze mbi pjesëmarrjen e shtetit tonë në gara të tilla duke vlerësuar lart marrëdhëniet ndërmjet dy vendeve në fushën e sportit. Të pranishëm në

takim ishin edhe presidenti i KOK-ut, Ismet Krasniqi, udhëheqësja e Divizionit për Federatën në MKRS, Afërdita Fazliu, kryetari i Federatës së Atletikës së Kosovës, Halil Sylejmani, dhe shefi i misionit, Fitim Arifi.



Sylvinho: Ëndërrojmë kualifikimin në 'Euro 2024'

TIRANË, 9 GUSHT - Pushimeve të Sylvinhos po u vjen fundi, ndërsa trajneri i kombëtares së Shqipërisë duket se po mendon që tani për sfidat e shtatorit në eliminoret e "Euro 2024" ku "kuqezinjtë" do të luajnë kundër Çekisë dhe Polonisë. Për këto dy sfida, aventurën e tij shqiptare, por edhe objektivat e së ardhmes, tekniku brazilian ka folur në një intervistë të gjatë për "Radio Marca" në Spanjë. "Ne e nisim planifikimin me stafin dhe kombëtarja është çështje e komplikuar. Në qershor ishte e vështirë për ngarkesat e punës, pushimet. Tani nga pak është pak më ndryshe, vjen nga faza përgatitore me pak ndeshje dhe duhet t'i gjejmë lojtarët më të përgatitur për dy ndeshjet që kemi më 7 dhe 10 shtator", u shpreh tekniku brazilian.

Sylvinho tregon për radion spanjolle edhe forcën e skuadrës kuqezi, por nuk harron ta nënvizojë edhe faktin se ende nuk e ka grupin e plotë për shkak të dëmtimeve. "Lojtarët janë të rinj, por të rëndësishëm, ka një përzjerje të mirë. Është mëkat për Kumbullën e Romës që u dëmtua, edhe Broja gjithashtu, kemi 2-3 lojtarë të rëndësishëm të dëmtuar. Por ka lojtarë shumë të mirë e të përkushtuar. Jam mahnitur me qasjen e tyre, të lojtarëve, se po japin gjithçka. Kjo më lumturon shumë", ka thënë Sylvinho. Tekniku kuqezi nuk e fsheh objektivin e parë madhor që beson se do ta arrijë në bankinën e kombëtares shqiptare. "Presioni nuk është, por është ëndrra e vendit. Megjithatë është një grup i fortë, i vështirë dhe shumë i



ekuilibruar. Gjërat po shkojnë kështu, të gjithë po luftojnë, edhe ne jemi në garë. Është e vështirë, një grup i komplikuar, por më pëlqen. Më pëlqen që të bëjmë punën mirë, detajet. Është një

ëndërr. Duam të jemi në Gjermani 2024", u shpreh lideri i bankinës së Kombëtares. Nga objektivat realë të ëndrrat e mëdha si, për shembull, një ndeshje kundër Brazilit me trajner

Ancelottin. "A e imagjinoj një Brazil - Shqipëri me Ancelottin në bankinën e Brazilit dhe Sylvinhon në atë shqiptare? Si jo, sigurisht që po. Ancelotti te Brazili derisa drejton Realin? Një temë e komplikuar, mungojnë shumë gjëra. Ancelotti është ndër më të mirët, të mos themi më i miri. Është një nga më të mëdhenjtë. I jashtëzakonshëm. Ai po bën gjëra të mëdha", u shpreh në fund të intervistës tekniku Sylvinho. Me Sylvinhon në bankinë, kombëtarja e Shqipërisë renditet në vendin e dytë të Grupit E eliminator të Euro 2024 me dy fitore dhe një humbje. Por vendimtare mund të jenë dy sfidat e shtatorit, ku kuqezinjtë do të luajnë kundër Çekisë në transfertë më 7 shtator dhe tri ditë më pas do ta presin Poloninë në "Air Albania".

Orari i Kosovës në Parakualifikimet Evropiane për Kupën e Botës 2027



PRISHTINË, 9 GUSHT - Pas hedhjes së shortit për Parakualifikimet Evropiane për Kupën e Botës 2027, është publikuar edhe orari i ndeshjeve. Kosova është në grup me Zvicrën, Irlandën dhe Azerbajxhanin. Sipas renditjes botërore, "Dardanët" ishin në vazon e dytë, ndërsa Zvicra e para. Irlanda ishte e treta dhe Azerbajxhani i katërti. Raundi i parë parakualifikues i Kupës së Botës të Basketbollit FIBA 2027 do të luhet në tre ditore më 19-27 shkurt 2024, 18-26 nëntor 2024 dhe 17-25 shkurt 2025, nga një

ndeshje në shtëpi dhe jashtë. Të tre fituesit e grupeve së bashku me skuadrën e renditur më të mirë në vendin e dytë do të kalojnë në raundin e dytë parakualifikues të Kupës së Botës 2027 të FIBA-s, i cili do të luhet në verën e vitit 2025. "Dardanët" sfidën e parë do ta kenë me Irlandën në shtëpi, më pas në udhëtim ndaj Azerbajxhanit. Në nëntor të vitit të ardhshëm, Kosova është mysafire e Zvicrës dhe Irlandës, ndërsa dy sfidat e fundit do të jenë në shtëpi kundër Azerbajxhanit dhe Zvicrës.

ORARI

Shkurt 2024
Kosova - Irlanda
Azerbajxhani - Kosova

Nëntor 2024
Zvicra - Kosova
Irlanda - Kosova

Shkurt 2025
Kosova - Azerbajxhani
Kosova - Zvicra

Ademi priti në takim gjyqtarët në prag të fillimit të edicionit të ri

PRISHTINË, 9 GUSHT - Kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi, ka pritur në takim gjyqtarët të cilët këtë fundjavë fillojnë ndarjen e drejtësisë në ndeshjet e edicionit të ri të garave 2023/2024 në futbollin e Kosovës. Në takim është diskutuar rreth formatit të delegimit, i cili këtë vit do të

jetë pak më ndryshe. "Delegimi i gjyqtarëve për ndeshje do të bëhet përmes shortit, i cili do të jetë transparent (transmetim i drejtpërdrejt në rrjetet sociale të FFK-së) dhe do të aplikohet për çdo xhiro. Gjyqtarët të cilët përmes shortit i bie të referoj ndeshjen e përcaktuar me short, është i obliguar të jetë në

krye të detyrës, me përjashtim të rasteve kur i njëjti e dëshmon se ka probleme shëndetësore ose për arsye të tjera", thuhet në njoftimin e FFK-së. Me këtë rast, presidenti Ademi u dëshiroi suksese gjyqtarëve në punën e tyre dhe u kërkoi të jenë sa më vigjilentë e të përgjegjshëm gjatë kryerjes së detyrës.



Osmani: Nuk ka maja që vajzat e Kosovës nuk mund t'i arrijnë

PRISHTINË, 9 GUSHT - Presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani, ka vizituar futbollistët e reja nga klubet "Prishtina" dhe "Brezovica". Ajo gjatë ditës së

sotme do ta përcjellë një ndeshje miqësore që do të realizohet mes këtyre dy klubeve. Përmes një video live në rrjetin

social "Facebook", Osmani u ka bërë thirrje vajzave të Kosovës të merren me sporte dhe me aktivitete sportive. "Nuk ka maja që vajzat e Kosovës

nuk mund t'i arrijnë", është shprehur Osmani. Më tutje, Osmani e ka uruar Kosovare Aslanin për Kupën e Botës me kombëtaren e Suedisë.



Përfaqësuesit e KF 2 Korriku u pritën nga Ademi

PRISHTINË, 9 GUSHT - Kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi, ka pritur sot në takim përfaqësuesit e të gjitha gjeneratave të Klubit KF 2 Korriku. Në këtë takim u bisedua rreth zhvillimit të këtij klubi në të gjitha kategoritë si dhe për përgatitjet për sezonin e ri të garave në Ligën e Parë për edicionin 2023/2024. Përfaqësuesit e KF 2 Korriku falënderuan kreun e FFK-së për pritjen dhe e njoftuan për ecurinë e punimeve që po bëjnë për

përmirësimin e infrastrukturës dhe të gjitha kushteve, me synimin që nga Liga e Parë të kalojnë sa më shpejt në Superligë, duke mos lënë anash as punën me të gjitha gjeneratat e tjera dhe ekipin e femrave me të cilin shpresojnë të kualifikohen në garat evropiane. Ata theksuan se kanë punuar edhe për krijimin e strategjisë për ekipin e femrave. Drejtuesit e këtij klubi shprehën interesimin për bashkëpunim në evitimin e problemeve për

financim dhe mundësitë e shfrytëzimit të ligjit të sponsorizimit. Kryetari Ademi ofroi mbështetjen e tij dhe i dëshiroi suksese në sezonin e ri të kampionatit në Ligën e Parë, duke uruar që këtë vit të mos shfaqen probleme sikurse në edicionin e kaluar. Ai shprehu shpresën që KF 2 Korriku të prodhojë sa më shumë talente, të cilët në të ardhmen mund të bëhen edhe pjesë e Përfaqësueses së Kosovës.



PSG-ja ndalon edhe shitjen e fanellave të Mbappes

PARIS, 9 GUSHT - Në mes të PSG-së dhe Kylian Mbappe nuk ka paqe, përkundrazi, vijon "lufta" e ftohtë në distancë. Së fundi, klubi francez ka hequr muralen e tij nga "Parku i Princave", ndërsa ka ndaluar shitjen e fanellave nga dyqani fizik i klubit. Për momentin fanella e kapitenit të Francës mund të blihet vetëm online. Më herët Mbappe nuk u përfshi në fazën përgatitore, ndërsa vijon të stërvitet i diferencuar. Lojtari pak kohë më parë njoftoi se nuk do ta rinovojë kontratën aktuale që i skadon më 2024, një vendim që nuk është pritur mirë nga stafi drejtues i PSG-së. Pavarësisht se i kanë të gjithë detajet kundër, PSG-ja nuk heq dorë nga kërkesa prej 250 milionë eurosh për ta lënë Mbappen të lirë. Real Madridi, klubi i destinuar për Mbappen, nuk nxitohet, por po pret me qetësi të kalojë koha, të



vetëdijshëm se në një moment edhe sheiku Al Khelafi do të thyhet, historia ka treguar se në raste të ngjashme fiton gjithnjë vullneti i lojtarit. Situata me Mbappen ka shqetësuar shumë

edhe trajnerin Luis Enrique, por klubi francez i ka bërë këtë të martën një tjetër dhuratë. Të gjithë mediet bashkohen në një pikë: Ousmane Dembele është lojtari më i ri i PSG-së.

SHKURT

Solomon përforcon Dukagjinin

KF Dukagjini po vazhdon përforsimet në këtë afat kalimtar. I fundit që "aterron" në Klinë është sulmuesi Theophilus Solomon. Futbollisti nga Nigeria ka qenë pjesë e Gjilanit në kampionatin e fundit, derisa ka luajtur edhe për Ballkanin. "Solomon nënshkruan kontratë me klubin tonë! Futbollisti nigerian Theophilus Solomon vjen nga skuadra e Gjilanit, ndërsa në Superligë është paraqitur edhe me klubin e Ballkanit. Qëndërsulmuesi Solomon ka mbi pesëdhjetë ndeshje në futbollin kroat dhe të Shqipërisë me klubet Sibenik, Istra dhe Partizani nga Tirana. Ai te Gjilani në nëntëmbëdhjetë paraqitje ka realizuar gjashtë gola dhe dy asistime", thuhet në njoftimin e skuadrës dukagjinase.

City, gati 81 milionë euro për Paquetan

Manchester City do të bëjë të tjera investime të mëdha në merkato. Synimi i radhës është Lucas Paqueta, ish-lojtar i Milanit. Brazili u transferua gjatë verës së kaluar nga Lyoni te West Hami për 43 milionë euro. 25-vjeçari zhvilloi 41 ndeshje, shënoi 5 gola, dhuroi 7 asistime dhe fitoi Ligën e Konferencës me skuadrën londineze. Manchester City ka përgatitur një ofertë prej 81 milionë eurosh për kartonin e lojtarit brazilian. Paqueta zbankoi në futbollin evropian në janarin e vitit 2019, kur u transferua nga Flamengo te Milani. 23.5 milionë euro e shiti klubi italian te francezët e Lyonit në shtatorin e vitit 2020.

Maguire transferohet te West Hami

West Ham Unitedi ka arritur marrëveshje në parim me Manchester Unitedin për të nënshkruar me Harry Maguire. Maguire do të kalojë në pjesën tjetër të Londrës, për rreth 30 milionë euro, raporton "Sky Sports". Kjo vjen edhe pas largimit të shiritit të kapitenit të qendërmbrojtësit nga ana e Unitedit. Ai ishte transferuar në "Old Trafford" për shifrën e 87 milionë eurove, duke u bërë mbrojtësi më i shtrenjtë.

Bayerni synon transferimin e Kepas

Yann Sommer u transferua në Inter, kurse Bayern Muncheni është në kërkim të një portieri që do të jetë zëvendësues i zviceranit. Portieri i parë i "bavarezëve", kapiteni Manuel Neuer, nuk pritet të rikthehet në fushën e blertë edhe për disa javë dhe Bayerni po kërkon një portier tjetër. Kepa Arrizabalaga është emri i ri në listën e dëshirave të kampionëve të Gjermanisë, me portierin spanjoll që është i gatshëm të largohet nga Chelsea. Londinezët kanë nënshkruar me Robert Sanchezin dhe Kepa nuk e ka të sigurt vendin e titullarit. Trajneri Thomas Tuchel ka punuar me portierin spanjoll edhe në "Stamford Bridges".

Barça konfirmon se Dembele do t'i bashkohet PSG-së

Ousmane Dembele tani është një hap larg Paris Saint-Germain. Zëvendëspresidenti i Barcelonës, Rafa Yuste, e konfirmoi diçka të

tillë pak orë më parë. "Ne jemi gati të arrijmë një marrëveshje me PSG-në. Ne po kujdesemi për këtë. Të gjitha palët duan që

marrëveshja të përfundojë sa më shpejt të jetë e mundur", ka thënë Yuste. Dembele do të transferohet në Paris pas pagesës së klauzolës

prej 50 milionë eurosh të parashikuar në kontratë. 26-vjeçari ka luajtur 25 ndeshje këtë sezon në "Camp Nou", ku ka

shënuar pesë gola dhe ka asistuar shtatë herë. Dembele ka luajtur më parë për Borussia Dortmundin dhe Rennesin.

NJOFTIM


Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Flemingo Kosovo” L.L.C. me seli në Fushë Kosovë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 810126278 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Flemingo Kosovo” L.L.C. Fushë Kosova, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810126278 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Flemingo Kosovo” L.L.C. with headquarters Fushë Kosovë, has come to the decision to quit its business: 810126278 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Cje Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 687 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Besnik Haxhidema shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 811881095.

- Arton Hoti shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme sh.m.l.e. “Hoxhë K. Prishtina.

- Mery's V& F- SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 810816621.

- Xheneta Ujkani shpall të pavlefshme diplomë e masterit drejtimi Ekonomiks në UP.

- Afrim Vehapi B.I. DPZ “ONIKS-1” shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, për import-export, me numër unik të biznesit: 810345654.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.



ROYAL CROWN



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

